

TË DHËNA FALAS?

Autor:

Driton Zhubi
Qëndresa Kukaj

Shmangie e përgjegjesisë:

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e LENS dhe nuk mundet në asnjë mënyrë të merret si pikëpamje e donatorit.

Publikuar nga:

LENS

Sylejman Vokshi 25 kati dytë nr. 6 10000 Prishtinë

Tel / 383 38 74 81 50

www.ngolens.org

Shtator, 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e LENS dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së

Përmbajtja

Përmbledhje	4
1. Metodologjia	5
2. Të dhënat personale	5
2.1. Përkufizimi ligjor i të Dhënave Personale dhe i të drejtave për mbrojtjen e tyre	5
2.2. Rregullimi ndërkombëtar	6
2.3. Rregullimi në Kosovë	7
3. Funksionimi ASHMDHP-së	9
3.1. Kompetencat e ASHMDhP-së	9
3.2. Organizimi i ASHMDHP-së	9
3.3. Punonjësit	11
3.4. Veprimtaria	11
4. Ndërlidhja e punës së ASHMDP-së me punën e institucioneve të tjera	20
4.1. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës dhe ndikimi i tij në punën e ASHMDhP-së	20
5. Shpenzimet, Transparenca dhe Llogaridhënia e Agjencisë	22
6. Përfundime dhe rekomandime	24

Përmbledhje

Fusha e mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë ende konsiderohet relativisht e re, por vëmendja në këtë çështje është duke u shtuar në mënyrë eksponenciale. Brengat e publikut janë shtuar po ashtu, qoftë për shkak të përdorimit në rritje të teknologjive moderne në vend, qoftë edhe për shkak të brengave në nivelin global. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, Institucionet e Kosovës janë përgjigjur relativisht me kohë dhe kënaqshëm në këtë brengë, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat janë krijuar ato institucione. Pra legjislacioni i Kosovës sot përfshinë dispozita ligjore të mjaftueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale. Institucioni kyç, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDhP) është themeluar dhe është në funksion ¹, përderisa gjyqësori dhe institucionet e tjera sado ngadalë, janë duke e zënë hapin. Sidoqoftë, në të ashtuquajturin “fshat global” ku bota konsiderohet si një komunitet i vetëm, i bashkuar përmes teknologjisë moderne të telekomunikimeve, Kosova nuk mund t’i ikë trendit në rritje e sipër të komercializimit të të dhënave personale. Pra, si individë, sado që kosovarët deri në një masë mund ta ndjejnë vetën të sigurt ose të mbrojtur në aspektin e privatësisë, si konsumatorë janë plotësisht të ekspozuar ndaj manipulimit pa pëlqim me të dhënat e tyre personale. Vigjilenca e institucioneve vendore në këtë aspekt nuk është asgjë tjetër pos edhe një segment i rregullimit të tregut dhe nuk mund të jetë më e avancuar se sa ajo në segmentet tjera.

Qëllimi i këtij hulumtimi është ofrimi i një analize të bazës ligjore, funksionimit, rolit dhe punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kosovës në aspektin e lartcekur. Hulumtimi është realizuar në kuadër të projektit “Rregullatori Yt” që ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së kësaj Agjencie dhe të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postale përmes informimit të qytetarëve për rolin dhe funksionin e këtyre trupave rregulluese dhe fuqizimin e tyre për të ngritur presionin publik për aplikim të standardeve më të larta të etikës në punën e institucioneve publike në përgjithësi, dhe të institucioneve rregullatorë në veçanti.

Për realizimin e këtij hulumtimi fillimisht është analizuar korniza ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale e aplikueshme në Kosovë dhe në Evropë, pastaj është analizuar mënyra e funksionimit dhe roli i ASHMDhP-së në mbrojtjen e të dhënave personale dhe është bërë një vlerësim i pasojave që ka pasur mos miratimi i projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në funksionimin e Agjencisë. Analiza ka vazhduar me një vlerësim të performancës së Agjencisë bazuar në të dhënat e paraqitura në raportet e saj vjetore, janë intervistuar zyrtarë të Agjencisë lidhur me sfidat në funksionalizimin e Agjencisë dhe arritjet e saj, si dhe janë intervistuar anëtarë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës me qëllim të njohjes së procesit të raportimit të Agjencisë në këtë komision. E gjithë analiza e funksionimit të Agjencisë është shoqëruar me vlerësim të efekteve të mos-miratimit të projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në këtë Agjenci dhe në funksionalitetin e saj.

Hulumtimi tregon se nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative të Agjencisë për shkak se që nga koha e themelimit, në qershor 2011, Agjencia ka funksionuar me një buxhet të kufizuar e numër të vogël të lejuar të personelit. Mos-miratimit i ligjit i cili ka shkaktuar një vakum me mungesë të mbikëqyrësve e ka ndikuar negativisht përmbushjen e dy prej kompetencave themelore dhe shumë të rëndësishme të Agjencisë, marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave dhe kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve.

Gjatë gjashtë viteve të funksionimit të saj Agjencia ka dhënë 231 këshilla dhe opinione për institucionet publike dhe private lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, i ka ofruar konsultime Qeverisë dhe Kuvendit për 291 masa legjislative, ka shqyrtuar 526 ankesa të qytetarëve lidhur me shkeljen e privatësisë dhe keqpërdorim të të dhënave personale, ka kryer 399 inspektime dhe 82 kontrolle, është anëtarësuar në

1 Për shkak të ndryshimeve në legjislacion, ASHMDhP prej 2016 është pak a shumë në gjendje gjysmë-funksionale por ajo pritet të ndryshojë.

organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ka zhvilluar fushata vetëdijesimi për qytetarët lidhur me të drejtat e mbrojtjes së të dhënave personale. Përkundër fushatave të zhvilluara, ueb faqja e Agjencisë nuk përmban informacione të mjaftueshme dhe lehtë të qasshme për qytetarët lidhur me të drejtat e tyre në këtë fushë.

Një aspekt që kërkon përmirësim në fushën e të dhënave personale është një kualitet më i lartë i raportimit të Agjencisë në komisionin funksional parlamentar përkatës (raportet aktuale kanë shumë përsëritje dhe ka nevojë për të dhëna më përmbajtjesore) kurse në anën tjetër kërkohet interesim më i lartë i anëtarëve të komisionit përkatës parlamentar për punën e Agjencisë. Duhet të ceket se e njëjta vlen për raportimin e shumicës, në mos të gjitha, agjencive.

Sa i përket transparencës, Agjencia ka të publikuara në ueb faqen e saj raportet vjetore të punës për vitet 2012-2015, në të cilat përfshihen aktivitetet e Agjencisë për vitin përkatës dhe të dhënat financiare të paraqitura në mënyrë shumë koncize; pastaj ka të publikuara pjesërisht vendimet dhe opinionet e saj lidhur me çështjet për të cilat subjektet private dhe institucionet publike kanë kërkuar mendimin e Agjencisë; legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar relevant për punën e Agjencisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale; dhe strategjinë e Agjencisë dhe planet vjetore të punës deri në vitin 2016.

1. Metodologjia

Punimi dhe shqyrtimi i materialeve është realizuar gjatë periudhës maj – gusht 2018.

Metodologjia për zhvillimin e hulumtimit ka ndjekur këtë rrugë:

- a. Janë grumbulluar të dhënat dhe informatat ekzistuese të përdorshme në hulumtim. Janë analizuar praktikat e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave në Kosovë dhe në BE, me theks ruajtja e të dhënave personale të konsumatorëve.
- b. Është shqyrtuar korniza ligjore e aplikueshme në Kosovë për mbrojtjen e të dhënave personale.
- c. Janë analizuar raportet vjetore të punës dhe janë zhvilluar intervista me zyrtarët e Agjencisë lidhur me mënyrën e funksionimit dhe rolin e ASHMDP-së në mbrojtjen e të dhënave personale nga perspektiva e mbrojtjes së konsumatorit dhe format e raportimit që bëhen në Kuvend
- d. Janë zhvilluar intervista me anëtarët e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së lidhur me raportimin e Agjencisë në këtë komision.

2. Të dhënat personale

2.1. Përkufizimi ligjor i të Dhënave Personale dhe i të drejtave për mbrojtjen e tyre

E drejta për privatësi është e drejtë themelore e njeriut, e përcaktuar me Deklaratën për të Drejtat e Njeriut të miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara më 1948². Me shtrirjen e gjerë të përdorimit të teknologjisë së informacionit në të gjitha fushat jetësore dhe me sasi të mëdha të të dhënave personale të akumuluar në formë elektronike rritet rreziku i cenimit të privatësisë së individëve, rrjedhimisht shkelja e kësaj të drejte të tyre themelore.

Është praktikë e zakonshme për subjektet e të dhënave të heqin dorë nga privatësia e tyre (ose t'ia bartin të drejtat e tyre një pale tjetër), pavarësisht vullnetit dhe vetëdijes së tyre, në këmbim të lehtësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve, në këmbim të ndonjë shërbimi shtesë, në të mirën e shëndetit individual e publik,

2 https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf

apo edhe në emër të sigurisë kombëtare.

Shqetësimet për mundësinë e keqpërdorimit apo përdorimit të paautorizuar të këtyre të dhënave për qëllime plotësisht të ndryshme nga ato për të cilat janë mbledhur kanë nxitur angazhimin e akterëve të ndryshëm në shoqëri për krijimin e një mjedisi ku potenciali për shkelje të privatësisë do të ishte i ulët. Ky mjedis përfshinë legjislacion që rregullon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, institucione që garantojnë zbatimin efektiv të këtij legjislacioni, biznese dhe institucione që njohin dhe respektojnë të drejtat e privatësisë dhe subjekte të të dhënave të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

Natyrisht, krijimi i një ambienti të tillë kërkon angazhim të të gjithë grupeve të interesit, pra rol të rëndësishëm luan edhe shoqëria civile qoftë me aktivitete për vetëdijësimin e qytetarëve dhe të bizneseve, qoftë me monitorimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve, ose edhe me rekomandimet e veta në legjislacion.

2.2. Rregullimi ndërkombëtar

Rregullimi ligjor i mbrojtjes së të dhënave personale ka filluar të bëhet relativisht vonë dhe ka shoqëruar digjitalizimin e institucioneve shtetërore. Akti i parë ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale daton në vitin 1973 në Suedi. Ky akt i quajtur Akti i të Dhënave kishte si synim të rregullonte mbrojtjen e privatësisë së informacionit të individëve të dhënat e të cilëve përpunoheshin me kompjuter³. Vite pas kësaj, çështja e mbrojtjes së privatësisë ka filluar të aktualizohet edhe në vende të tjera dhe shumë shtete të tjera kanë adoptuar ligje për këtë çështje. Megjithatë, ka ndryshime të mëdha ndërmjet legjislacionit nëpër vende të ndryshme.

Bashkimi Evropian duke parë rëndësinë dhe vlerën e të dhënave personale, potencialin e tyre për përdorim në fushën ekonomike dhe implikimet e keqpërdorimit të të dhënave, ka filluar rregullimin e përdorimit të të dhënave personale me direktivat e veta që nga gjysma e dytë e viteve 90ta. Kështu BE në vitin 1995 ka miratuar direktivën 94/46 EC. Kjo direktivë, e hyrë në fuqi më 24 Tetor 1995, ka ofruar një kornizë rregulluese nëpërmjet së cilës janë mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik, veçanërisht e drejta e tyre për privatësi në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Përveç kësaj, me këtë rregullore janë nxitur shtetet anëtare që të themelojnë institucione të pavarura që mbikëqyrin përpunimin e të dhënave personale, si dhe sigurimin e qarkullimit të lirë të të dhënave ndërmjet shteteve anëtare⁴.

Sipas përkufizimeve të kësaj rregulloreje⁵, e dhënë personale konsiderohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është çdo person fizik i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti duke iu referuar një identifikuesi si një emër, një numri identifikimi, të dhënave për vendndodhjen, një identifikuesi online ose një ose më shumë faktorëve specifikë për identitetin fizik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi. Ky përkufizim është adoptuar edhe në legjislacionin kosovar dhe i njëjti do të përdoret në këtë hulumtim.

Direktiva 95/46 EC është zëvendësuar me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) e cila është miratuar në vitin 2016 dhe ka hyrë në fuqi më 25 maj 2018. Bazuar në parimet e vendosura nga direktiva e mëparshme, kjo rregullore promovon përpunimin e të dhënave në mënyrë të ligjshme, të paanshme dhe transparente, pa tejkalluar qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe duke i mbrojtur ato nga qasjet e paautorizuara dhe joligjore. Veç kësaj, kjo rregullore i shërben edhe qëllimit të harmonizimit të ligjeve të vendeve anëtare ashtu që personat fizik të gëzojnë të njëjtin nivel të të drejtave dhe të mbrojtjes në tërë Bashkimin Evropian. (Në këtë drejtim, edhe Kosova, e udhëhequr nga aspiratat për arritje të standardeve

3 <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/47-18.pdf>

4 Legjislacioni në fuqi dhe aplikimi, Lens, 2016, faqe 5

5 Neni 2, 95/46/EC

Evropiane dhe për integrim në BE ka bërë përpjekje për miratim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.)

Krahas përmirësimeve të provizioneve ekzistuese, reforma gjithashtu sjellë rregulla krejtësisht të reja për të forcuar edhe më tej kontrollin e subjektit mbi të dhënat e veta personale. Në lidhje me fushën materiale të zbatimit, RPMDH-ja e re dhe Udhëzimi 2016/680 vlen për përpunimin e të dhënave personale në tërësi ose pjesërisht në mënyrë automatike si dhe të përpunimit me mënyra tjera përpos atyre automatike të të dhënave personale të cilat formojnë pjesë të një sistemi të renditjes/ruajtjes ose kanë për qëllim të formojnë pjesë të një sistemi të renditjes/ruajtjes.

2.3. Rregullimi në Kosovë

Faktorë të ndryshëm si nevoja për digjitalizim të institucioneve publike pas luftës dhe penetrimi i lartë i internetit në Kosovë⁶ kanë shkaktuar qarkullimin e një numri të madh të dhënave personale në internet. Kjo, bashkë me aspiratat e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe harmonizim të legjislacionit, kanë nxitur trajtimin dhe mbrojtjen institucionale të të dhënave në vend.

Ligji nr. 03/I-172 për mbrojtjen e të dhënave personale

Ligji i parë në Kosovë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ligji nr. 03/I-172, i cili ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2010 duke shfuqizuar dhe zëvendësuar pjesën shtatë të Ligjit nr. 02/L-23 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike mbi përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e fshehtësisë së tyre⁷. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të themelojë institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.⁸

Ky ligj përcakton se “Të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.”⁹, ato nuk mund të përpunohen përtej qëllimit të caktuar për të cilin janë mbledhur, saktësia e të dhënave duhet të verifikohet para grumbullimit të tyre, si dhe pas përmbyshjes së qëllimit për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar, të dhënat duhet të asgjësohen, të fshihen, të bllokohen ose të bëhen anonime (përveç nëse është përcaktuar ndryshe me Ligjin për Lëndën Arkivore)¹⁰. Këto parime vlejné për përpunimin e të dhënave nga organet publike dhe private, nga zyrat diplomatike dhe konsullore si dhe të gjitha përfaqësitë tjera të Republikës së Kosovës jashtë vendit dhe nga kontrolluesit e të dhënave të themeluar jashtë Kosovës por që përdorin pajisje automatike të përpunimit të të dhënave në Kosovë (Përveç kur përdoret si transit)¹¹.

Gjithashtu me këtë ligj përcaktohet se të dhënat mund të përpunohen nëse është marrë pëlqimi nga subjekti i tyre apo nëse ky përpunim është i domosdoshëm për përmbyshjen e ndonjë kontrate ku subjekti i të dhënave është palë kontraktuese; respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave, ose për kryerjen e ndonjë detyre me interes publik.¹² Neni 10 i këtij ligji përcakton të drejtat e subjektit të të dhënave për informacion lidhur me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të tij/saj. Kështu, në rastin kur të dhënat mblidhen drejtpërdrejtë nga subjekti i tyre, kontrolluesi duhet ta informojë atë për identitetin e kontrolluesit dhe përpunuesit të të dhënave,

6 Sipas “Pasqyrës së Tregut të Komunikimeve Elektronike” të publikuar nga ARKEP, penetrimi i internetit në Kosovë me qasje brezgjërë fikse dhe mobile deri në tremujorin e dytë të vitit 2017 ishte 79.52%.

7 Legjislacioni në fuqi dhe aplikimi, Lens, 2016, faqe 8

8 Neni 1 LMDP

9 Neni 3 par 1 LPMD

10 Neni 3 LPMD

11 Neni 4 LMDP

12 Neni 5 LMDP

qëllimin e përpunimit, nëse përgjigjet janë të detyrueshme ose vullnetare dhe për pasojat e mosdhënies së përgjigjes, si dhe për të drejtat për qasje, transkriptim, kopjim, plotësim, korigjim, bllokim dhe asgjësim të të dhënave personale. Ndërsa në rastin kur të dhënat nuk janë mbledhur drejtpërdrejtë nga subjekti, ajo/ai duhet të njoftohet edhe për origjinën e të dhënave¹³.

Përveç të drejtave, me këtë ligj përcaktohen edhe kufizimet e mbrojtjes së të dhënave, me ç'rast, të drejtat e subjektit të të dhënave mund të kufizohen për arsye të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, parandalimit dhe hetimit të veprave penale e shkeljeve të etikës profesionale, si dhe mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Më tej, ky ligj themelon Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si agjenci të pavarur, të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Përgjegjësitë, funksionimi dhe detyrat e kësaj agjencie do të përshkruhen në seksionet në vazhdim.

Në fund, ligji përcakton të drejtat e kontrolluesve të të dhënave dhe dispozitat ndëshkuese në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji.

Projektligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale

Në vitin 2014 është iniciuar projektligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale i cili do të shfuqizonte ligjin aktual. Miratimi i këtij ligji është zgatur për shkak të kundërshtimeve të palëve të ndryshme dhe është miratuar në Qeveri vetëm më 5 Qershor të vitit 2018¹⁴. Shqetësime për këtë ligj kanë shprehur disa përfaqësues të shoqërisë civile¹⁵, duke përdorur si argument kryesor kundër miratimit të këtij ligji pohimin se Agjencia nuk funksionon si institucion i pavarur, përkundër përcaktimit ligjor si e tillë, pastaj varësinë e fuqisë ekzekutive të komisionarit në funksionimin e rregullt të sistemit gjyqësor, mungesën e përgatitjes së duhur në Kosovë për pozitën e komisionarit dhe mungesën e vullnetit politik për të mundësuar funksionimin e pavarur të Agjencisë. Një provizion veçanërisht kontradiktor ka qenë ai i cili autorizimet për implementimin e legjislacionit mbi qasje në dokumente publike e bartë nga Avokati i Popullit, tek Agjencia e reformuar.

Nga Qeveria në muajin Maj 2017 është miratuar koncept - dokumenti që ka përcaktuar që mbikëqyrja e zbatimit në shkallë të dytë e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike të jetë në kompetencën e Agjencisë ku është paraparë edhe shtimi i zyrtarëve dhe shtimi i buxhetit, për një funksionalizim më të plotë të Agjencisë me kompetenca të zgjeruara dhe në shqiptimin e masave ndëshkuese gjobave për kundërvajtje të cilat janë paraparë në ndryshimet ligjore si në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Vlen të ceket se në muajin qershor 2018 janë aprovuar dy draft ligjet (ligji për mbrojtje të dhënave personale dhe ligji për qasje në dokumente publike) nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe tani kanë kaluar për shqyrtim në Kuvend. Kostoja financiare është aprovuar në Ministri të Financave dhe Qeveri që Agjencia do t'i ketë gjithsejtë 41 zyrtar me miratimin e ligjeve të reja si dhe shtimin e buxhetit për realizimin e projekteve dhe në zbatimin e dy ligjeve.

Projektligji i ri përfshin më shumë aspekte të mbrojtjes së të dhënave, si të dhënat e mbledhura nga dronët, të dhënat personale nga institucionet e mëparshme, dokumentet zyrtare dhe librat publikë dhe parasheh zgjerimin e kompetencave të Agjencisë edhe në mbikëqyrjen e qasjes në dokumente publike. Një ndryshim tjetër madhor i paraparë me këtë ligj është kalimi nga forma e udhëheqjes së Agjencisë nga Këshilli në udhëheqje nga Komisionari. Komisionarit do t'i shtohen kompetenca ekzekutive për shqiptimin e gjobave në rast të identifikimit të rasteve të shkeljeve të privatësisë ose mos garantimit të qasjes në dokumente publike. Për atë se si legjislacioni në Kosovë e mbulon çështjen e privatësisë Lens ka publikuar një hulumtim në vitin 2016 lidhur me Legjislacionin në fuqi dhe aplikimin e tij¹⁶. Në këtë hulumtim paraqitet një analizë e përfshirjes

13 Neni 10 LMDP

14 <http://kryeministri-ks.net/miratohet-projektligji-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale-projektligji-per-qasje-ne-dokumente-publike-dhe-plani-i-veprimet-per-cilesine-e-ajrit/>

15 <https://sbunker.net/op-ed/60592/nisma-per-ta-forcuar-censuruesin-e-deshmuar/>

16 <http://www.digitalrightskosovo.com/file/2017/05/Legjislacioni-n%C3%AB-fuqi-dhe-aplikimi.pdf>

së çështjes së privatësisë në ligje të tjera si Ligji për arkivat shtetërore, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për qasje në dokumente publike, Ligji për komunikimet elektronike, Ligji për Përgjimet Elektronike. Ndërsa, një ligj tjetër që nuk është trajtuar në hulumtimin e lartcekur është ai për Gjendjen civile.

3. Funksionimi ASHMDHP-së

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar në vitin 2010 me Ligjin 03/L-172 Për mbrojtjen e të dhënave personale. Me nenin 29 par. 1 të këtij ligji ajo themelohet si “Agjenci e pavarur, e ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave”¹⁷. Ky nen gjithashtu përcakton që anëtarët e agjencisë duhet të veprojnë të pavarur dhe të mos pranojnë udhëzime nga ndonjë palë e tretë dhe që Agjencia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

ASHMDhP në vitet e para të funksionimit të saj është ndodhur në mes të periudhës së ndërrimit të legjislacionit. Si rrjedhojë e vonësive në miratimin e projektligjit është shkaktuar një gjendje amullie në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Padyshim që kjo situatë e ka ndikuar edhe funksionimin normal të Agjencisë, prandaj në këtë punim i gjithë funksionimi i Agjencisë do të shikohet nga këndvështrimi i këtyre dy ligjeve, përcjellë me analizë të pasojave të kësaj zvarritje në funksionimin e Agjencisë. Vlen të ceket po ashtu që edhe mbikëqyrja e Agjencisë ka qenë jo-komplete dhe në një mënyrë edhe arbitrare duke e pasur parasysh kalimin e tej zgjatuar nga njeri ligj tek tjetri.

3.1. Kompetencat e ASHMDhP-së

Kompetencat e Agjencisë (Me nenin 29 të ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale) përfshijnë:

- Dhënien e këshillave organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave;
- Marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
- Kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve;
- Informimin e publikut për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave; dhe
- Promovimin dhe përkrahjen e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për më tepër, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës janë të obliguara me ligj ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale dhe të konsultohen me Agjencinë para miratimit të masave të tilla¹⁸. Përmes këtij ligji Agjencisë gjithashtu i jepet e drejta për padi në gjykatën kompetente kur konsideron se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur dhe gjithashtu i jepet e drejta të parashtrijë kërkesë tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve e akteve nënligjore kur konsideron që ato nuk janë në harmoni me nenin 36 për mbrojtje të të dhënave në Kushtetutën e Kosovës. Këto kompetenca nuk parashihen të ndryshojnë as me projektligjin e ri. Në këtë hulumtim do të analizojmë performancën dhe të arriturat e Agjencisë në këto fusha përgjegjësie të përcaktuara për të me ligj.

3.2. Organizimi i ASHMDHP-së

Ligji për të dhënat personale (i cili tashmë është në ndryshim e sipër) rregullon vetëm aspektin e udhëheqjes së Agjencisë, ku është përcaktuar që Agjencia të kryesohet nga Këshilli dhe është specifikuar që numri i anëtarëve të Këshillit duhet të jetë pesë (5), është përcaktuar procedura e zgjedhjes dhe shkarkimit të tyre si dhe kushti për pavarësinë e tyre (nenet 30-35). Ndërsa organizimi dhe funksionimi i mëtejshëm i Agjencisë rregullohet me akte nënligjore të nxjerra nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror.

17 LPMDP Neni 29

18 LPMDP Neni 39

Në përputhje me ligjin, puna e Agjencisë fillimisht është rregulluar me rregulloren 20/2011 për punën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Më pas kjo rregullore është plotësuar me rregulloren Nr. 01/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës , e cila ka përcaktuar strukturë të re organizimi, mirëpo e cila asnjëherë nuk është vënë në funksion plotësisht për shkak të kufizimeve buxhetore.

Këshilli

Këshilli është organi kryesues i Agjencisë dhe përbëhet nga një Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror dhe katër Mbikëqyrës Shtetëror (03/L-172, neni 30). Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka përgjegjësi për përfaqësimin e Agjencisë si dhe organizimin dhe koordinimin e punës së saj. Ajo/ai emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës për një periudhë pesë (5) vjeçare me mundësi të emërimit edhe për një mandat. Me rregulloren për punën e Agjencisë, Këshillit i përshkruhen të gjitha kompetencat që i janë përshkruar Agjencisë me nenin 29 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe i shtohen kompetencat në vijim ¹⁹:

1. Hartimi i raportit vjetor të punës;
2. Vendimi për publikimin e gazetës së Agjencisë dhe literaturës profesionale;
3. Nxjerrja e akteve nën ligjore, autorizimeve dhe vendimeve;
4. Aprovimi i propozim buxhetit të Agjencisë;
5. Marrja e vendimeve për transferimin e të dhënave personale;

Kjo formë e udhëheqjes së Agjencisë mund të ndryshojë me miratimin e projektligjit aktual për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit parashihet që Agjencia të udhëhiqet nga Komisioneri i cili ka përgjegjësi për përfaqësimin e Agjencisë dhe koordinimin e punës së saj. Përveç Këshillit (komisionerit me ligjin e ri), Agjencia ka edhe Drejtorin e Përgjithshëm, pozicion i cili tani parashihet edhe në projektligjin e ri, i cili kryen të gjitha detyrat e Zyrarit Kryesor Administrativ, në pajtim me legjislacionin përkatës ²⁰.

Departamentet

Sa i përket departamenteve të Agjencisë ishte paraparë që ato të organizohen në fushën e administratës dhe mbështetjes dhe në fushat profesionale operacionale. Kështu, me këtë rregullore ishte paraparë që në kuadër të Agjencisë të funksionojnë këto pesë departamente:

1. Departamenti i çështjeve ligjore dhe procedurale
2. Departamenti i regjistrimit
3. Departamenti i Hetim-Inspektimit
4. Departamenti për marrëdhënie me jashtë dhe marrëdhënie me publikun
5. Departamenti i administratës dhe shërbimeve mbështetëse

Mirëpo, numri i këtyre departamenteve me rregulloren 01/2013 është reduktuar në tri departamente dhe një zyrë. Departamenti i regjistrimit është shkruar me departamentin e Marrëdhënieve me jashtë, ndërsa Departamenti i Hetim-Inspektimit është shndërruar në Zyrë për Mbështetje të Inspektimit. Sipas Agjencisë, "Që nga koha e themelimit, në qershor 2011, Agjencia ka funksionuar me një buxhet të kufizuar e numër të vogël të lejuar të personelit dhe për këtë arsye nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative"²¹ . Në organizimin aktual Departamenti Ligjor ka përgjegjësi për hartimin e akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale; ndjekjen e procesit të shqyrtimit të lëndëve dhe përfaqësimit juridik në gjykatën kompetente; dhe koordinimin dhe menaxhimin e përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave

19 [http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Rregullorja_e_Punes_NAPPD_05_08_2011_\(2\)_\(2\).pdf](http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Rregullorja_e_Punes_NAPPD_05_08_2011_(2)_(2).pdf) neni 7

20 Projektligji, neni 55, paragrafi 3

21 http://www.amdp-rks.org/repository/docs/ashmdhp_raporti_vjetor_2015_ALB.pdf faqe 13

personale. Ky departament ka divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit dhe Divizionin për Përfaqësim Gjyqësor.

Departamenti për regjistrim dhe marrëdhënie me jashtë është përgjegjës për realizimin e komunikimit bashkëpunues me të gjitha departamentet e Agjencisë dhe me të gjithë zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të organeve publike, si dhe subjektet kontrolluese të të dhënave ²². Ky departament përbëhet prej Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Regjistrimit dhe Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë dhe me Publikun. Departamenti i administratës është përgjegjës për menaxhimin e resurseve njerëzore, organizimin e brendshëm, menaxhimin e buxhetit dhe financave, mbështetjen administrative dhe logjistike si dhe ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, përkthimit, arkivimit dhe shpërndarjes së materialit.

Zyra për mbështetje të inspektimit sipas rregullores ka përgjegjësi për mbështetjen e drejtpërdrejtë të mbikëqyrësve në kryerjen e detyrave të inspektimit dhe kontroleve. Kjo zyrë gjithashtu përgatitë këshilla për mbikëqyrësit shtetërorë lidhur me legjislacionin në fuqi në fushën e inspektimit dhe kontrollit. E gjithë kjo strukturë mund të ndryshojë me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky ligj parasheh që përveç fushës së mbrojtjes së të dhënave personale Agjencia të jetë përgjegjëse edhe për fushën e qasjes në dokumente zyrtare. Kësisoj, struktura organizative e Agjencisë do të duhet të mbështetet në këto dy shtylla. Organizimi i mëtejshëm do të përcaktohet me akte nënligjore që nxirren nga komisioneri. Ky punim në atë rast do të përditësohet dhe përshtatet.

3.3. Punonjësit

Agjencia në vazhdimësi të veprimtarisë së saj është ndeshur me pamjaftueshmërinë e numrit të punonjësve civilë. Agjencia vlerëson që përkundër faktit që për përmbushje të strukturës së saj të përcaktuar me rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës është e nevojshme të angazhohen 37 punonjës, ajo ka funksionuar përgjatë gjithë historisë së saj me shumë më pak punonjës. Numri i punëtorëve për vitet 2012-2015 është dhënë në tabelën në vijim.

	2017	2016	2015	2014	2013	2012
Funksionar Publik të Emëruar	0	5	5	5	5	5
Administrata Qendrore	18	15	18	18	14	12
Total	18	20	23	23	19	17

Tabela 1. Numri i punonjësve të Agjencisë sipas viteve

Ndryshimi i ligjit parasheh edhe ndryshimin e numrit të të punësuarve, ku agjencia do të ketë 41 të punësuar. Agjencia për momentin ka vetëm 18 zyrtarë por me përvojë 7 vjeçare në këtë fushë. Sipas zyrtarëve të Agjencisë, këto dy elemente tregojnë se Agjencia me këto kapacitete dhe me shtimin e zyrtarëve të tjerë të paraparë, do të mund të mbikëqyrë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të atij për qasje në dokumentet publike. Megjithatë, ata konsiderojnë që zyrtarët e Agjencisë kanë nevojë për trajnime shpesh duke e ditur fushën specifike që udhëheqin.

3.4. Veprimtaria

Siç u shpjegua më sipër, veprimtaria e Agjencisë përfshin informimin e publikut për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, promovimin dhe përkrahjen e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale, dhënien e këshillave organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të

dhënave, marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e subjekteve të të dhënave, dhe kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve. Në këtë seksion po paraqesim të dhëna për punën e Agjencisë përgjatë viteve në secilën nga këto fusha.

3.4.1. Informimi i publikut dhe promovimi i të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale

Puna në mbrojtjen e të dhënave personale fillon me vetëdijesimin e qytetarëve me të drejtat e tyre në këtë fushë, informimin e kontrolluesve të të dhënave me obligimet dhe të drejtat e tyre dhe trajnimin e zyrtarëve shtetërorë për trajtimin e rasteve të mundshme të shkeljes së të drejtave të privatësisë. Kjo fushë bie nën kompetencat e Agjencisë dhe gama e aktiviteteve të realizuara nga Agjencia për qëllime vetëdijesimi dhe promovimi është e gjerë dhe përfshin fushata me video informuese, konferenca, trajnime, seminare, ligjërata, publikim udhëzuesish, ekspozita etj.

Çdo vit Agjencia përcakton një sektor prioritar në të cilin do t'i drejtojë përpjekjet e saj për vetëdijesim të publikut. Dy kriteret bazë të cilat përdoren për të përcaktuar prioritet janë numri i ankesave për shkelje të të drejtave të privatësisë në secilin sektor dhe vrojtimet e dukurive dhe zhvillimeve në fushën e përdorimit të të dhënave personale. Sipas këtyre kriteret për vitin 2016 është përcaktuar si sektor me prioritet më të lartë sektori i arsimit kurse në vitin 2017 ai i shëndetësisë. Përgjatë viteve Agjencia ka zhvilluar fushata vetëdijesimi dhe konferenca për mbrojtjen e privatësisë në këta sektorë. Ndër më të veçuarat janë fushatat “Privatësia ime” dhe “Privatësia në epokën dixhitale” me nxënësit e shkollave të mesme.

Ndonëse këto dy kriteret mund të jenë mënyra dhe matësi më i zbatueshëm/praktik i shkeljeve të të drejtave për mbrojtje të të dhënave personale në Kosovë, ato shoqërohen me disa kufizime të rëndësishme. Fillimisht, mund të spekulohet se numri i ankesave të paraqitura është i lidhur ngushtë me vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat e tyre dhe për ekzistencën e një autoriteti që i mbron ato. Rrjedhimisht, sektorët në të cilët është zhvilluar ndonjë formë e aktiviteteve të vetëdijesimit kanë tashmë prirje më të larta për të raportuar shkeljet, duke bërë kështu që disa sektorë të caktuar të mbesin prioritet për vite me radhë vetëm pse pranohen ankesa nga to, pavarësisht faktit që në këto sektore është arritur një nivel i caktuar i vetëdijesimit. Prandaj, një metodë efektive për të zbutur këtë efekt do të ishte anketimi i grupit të synuar nga secili sektor pas disa raundesh fushatash vetëdijesimi për të vlerësuar nivelin e tyre të njohurive për të drejtat e tyre të privatësisë dhe për mundësinë e paraqitjes së shkeljeve te autoritetet kompetente.

Në Agjenci thonë se ata që nga themelimi i saj e deri më tani kanë realizuar anketa dhe hulumtime për të vlerësuar këto dy aspekte, rezultatet e të cilave janë përdorur, veç të tjerash, edhe për dizajnimin e fushatave të ardhshme vetëdijesuese. Në një nga këto anketa ka rezultuar që 45% e qytetarëve të anketuar në Republikën e Kosovës kanë pasur njohuri që ekziston një institucion për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vetëm 54.5 % nga ata që e kanë pohuar këtë e kanë ditur që institucioni përkatës është Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mostra e këtij studimi ka qenë 150 persona.

Për dallim, në një anketë të zhvilluar në vitin 2017 nga Lens mbi privatësinë në internet del se vetëm 35.5% e qytetarëve e dinë se ku duhet të ankohen në rast të shkeljes së privatësisë së tyre. Përderisa 17.1% e respondentëve kanë treguar se atyre u është shkelur të paktën një herë privatësia por vetëm 3.7% prej tyre kanë i kanë raportuar këto shkelje. Mostra e këtij studimi ka qenë 500 persona. Të dy këto anketa tregojnë nivel të ulët të njohurisë së qytetarëve rreth privatësisë.

Megjithatë, as rezultatet e anketave të zhvilluara nga Agjencia dhe as të anketës së zhvilluar nga Lens nuk tregojnë efektin/impaktin e punës promovuese dhe sensibilizuese të Agjencisë, por vetëm nivelin momental të njohurive të qytetarëve për privatësinë, ligjin për privatësinë dhe institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Një hulumtim/vlerësim i mëtejshëm i bazuar në krahasimin e nivelit të njohurive të qytetarëve para dhe pas funksionalizimit të Agjencisë i shoqëruar me një analizë të përmbajtjes së fushatave të realizuar

do të ishte i dobishëm në këtë aspekt.

Një kufizim tjetër paraqet fakti se vrojtimi me qëllim prioritizimi bëhet nga stafi i Agjencisë përmes mediave dhe rasteve të vërejtura në përditshmëri. Për t'u realizuar në mënyrë të duhur ky vrojtim do të ishte e nevojshme të angazhohej staf i veçantë për përcjellje të të gjitha mediave dhe të zhvillimeve të vazhdueshme në shoqëri. Duke marrë parasysh se stafi i Agjencisë ka qenë i pamjaftueshëm përgjatë këtyre gjashtë viteve dhe se disa funksionarë të Agjencisë është dashur të kryejnë deri në 5 funksione jashtë pozitës së tyre zyrtare të përshkruar, kjo rritë gjasat për ikje nga vëmendja të shumë rasteve dhe veçim të vetëm rasteve që janë më të ekspozuara në media dhe më të përfolura në shoqëri. Duke lënë kështu sërish nën hije sektorë dhe grupe që nuk janë mjaftueshëm të informuar për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe raportimin e shkeljes së kësaj të drejte. Shumë raste mund të dalin në pah vetëm gjatë periudhave të ndryshme kur procese të rëndësishme ndodhin në shoqëri, si për shembull zgjedhjet lokale dhe/ose nacionale, dhe kështu të lënë në hije sektorë të tjerë ku shkeljet janë të vazhdueshme.

Megjithatë, puna informuese dhe vetëdijesuese e agjencisë ka mbuluar edhe edukimin në baza të rregullta. Për më tepër, gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2014 Agjencia ka zhvilluar trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Pastaj, gjatë vitit 2017 ka publikuar një udhëzues për subjektet politike rreth komunikimit me qytetarë gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu gjatë viteve 2014 dhe 2013 Agjencia ka zhvilluar spote televizive me synim ndërgjegjësimin e kategorive të ndryshme të qytetarëve rreth mbrojtjes së të dhënave të tyre personale. Përderisa gjatë vitit 2012 Agjencia ka promovuar broshurën për mbrojtjen e të dhënave personale; ka mbajtur trajnime për rreth 700 zyrtarë në nivel vendi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kodit të etikës; gjithashtu ka mbajtur seminar me zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Postën dhe Telekomin e Kosovës dhe me institucione private, si dhe ka bërë 59 publikime të ndryshme që kanë pasur për qëllim informimin dhe promovimin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë këtu edhe konferencat për shtyp të organizuara nga Agjencia.

3.4.2. Këshilla dhe opinione

Këshillat dhe opinionet janë gjithashtu pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Agjencisë. Dhënia e këshillave dhe opinioneve është përgjegjësia e parë që i është përshkruar Agjencisë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kuadër, Agjencia jep këshilla dhe opinione për kontrolluesit privat dhe publik të të dhënave lidhur me përshtatshmërinë e proceseve të përpunimit të të dhënave personale. Deri më tani ajo ka dhënë 231 opinione dhe këshilla, të paraqitura sipas viteve në tabelën në vijim.

Viti	Numri i opinioneve të dhëna	Numri i këshillave të dhëna
2012	2	29
2013	4	26
2014	10	32
2015	8	36
2016	2	40
2017	Nuk ka të dhëna	42
Total	26	205

Tabela 2. Numri i opinioneve dhe këshillave të dhëna nga Agjencia sipas viteve

Lëndët për të cilat janë kërkuara opinione nga Agjencia janë të ndryshme dhe ato janë kërkuar nga institucione të ndryshme shtetërore, agjenci të pavarura, institucione shëndetësore, qeveri lokale, institucione financiare, organizata sindikale dhe organizata mediale. Kjo tregon për nivel më të lartë të njohurive të institucioneve publike e private dhe gatishmëri të institucioneve shtetërore e private për respektim të të drejtave të privatësisë.

Me ligj gjithashtu është e përcaktuar që institucionet shtetërore duhet ta informojnë Agjencinë dhe të konsultohen me të para aprovimit të masave legislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përdorimin e të dhënave personale. Gjatë gjashtë viteve të funksionimit Agjencia ka dhënë konsultime për hartimin e 291 masave Legislative dhe Administrative nga institucionet shtetërore. Këto akte/masa përfshijnë projektligje, projekt-rregullore, projekt-udhëzime administrative dhe dokumente të tjera si memorandume shpjeguese, draft-marrëveshje, memorandume mirëkuptimi, koncept dokumente dhe akte të tjera. Numri dhe lloji i akteve ligjore për të cilat Agjencia ka dhënë konsultime gjatë viteve 2012-2017 është i dhënë në tabelën në vijim.

Viti	Projektligje	Projekt rregullore	Projekt-udhëzime administrative	Dokumente të tjera	Total
2012	4	19	4	6	33
2013	8	7	4	8	27
2014	3	18	27	17	65
2015	1	12	9	5	27
2016	10	11	22	10	53
2017	15	14	41	16	86
Total	41	81	107	62	291

Tabela 3. Numri i konsultimeve të dhëna nga Agjencia sipas viteve dhe llojit të masave legislative

3.4.3. Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve

Secili qytetar e gëzon të drejtën për të parashtruar ankesë pranë Agjencisë në rast se konsideron se e drejta e tij ose saj për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur. Agjencia është përgjegjëse për shqyrtimin e këtyre ankesave dhe për informimin e ankuesit menjëherë pas shqyrtimit të ankesës së saj/tij²³. Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave është një ndër funksionet më të rëndësishme të Agjencisë sepse në bazë të ankesave të pranuar dhe natyrës së tyre përcaktohen programi vjetor i inspektimeve dhe kontrollit dhe nevojat për fushata vetëdijesuese dhe promovuese.

Qytetarët mund t'i parashtrojnë ankesat e tyre pranë Agjencisë në mënyrë elektronike, të shkruar ose verbale²⁴. Procedura e ankimit përcaktohet me rregulloren e ASHMDP-së Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave. Sipas kësaj rregulloreje, çdo ankesë duhet të dorëzohet në ndonjë nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe pavarësisht mënyrës në të cilën paraqitet ankesa, asaj duhet t'i bashkëngjiten dokumentet që dëshmojnë shkeljen.

Në rregullore përcaktohen elementet që duhet t'i përmbajë ankesa për çdo formë në të cilën paraqitet te Agjencia. Këto elemente përfshijnë emërtimin e Agjencisë si organ kompetent, një indikacion lidhur me kompetencat në kuadrin e të cilave kërkohet veprimi i organit, veprimi konkret që kërkohet nga Agjencia, shkaqet dhe faktet që qëndrojnë në themel të kërkesës për veprim nga Agjencia, të dhënat e ankuesit, të dhënat e kontrolluesit të të dhënave, përshkrimin e ankesës dhe datën e nënshkrimit e ankuesit.

Pas pranimi të ankesave në Agjenci ato regjistrohen në një bazë të të dhënave (numri i ankesës, data e

23 LPMDP Nenet 40, 41

24 Neni 41 par 2 LPMDP

paraqitjes, titulli i ankesës, numri dhe emërtimi i dokumenteve që i janë bashkangjitur ankesës, emri dhe adresa e ankuesit). Më pas këto ankesa dorëzohen te zyrtari i arkivës për hapje të lëndës dhe pastaj tek mbikëqyrësi kryesor shtetëror nga ku i caktohen për shqyrtim një zyrtari apo mbikëqyrësi (Tani kjo përgjegjësi i është bartur Drejtorit të Përgjithshëm, si autoriteti më i lartë në Agjenci). Pasi që ankesa t’i jetë caktuar një zyrtari për shqyrtim, ajo/ai duhet të heqë dorë nga shqyrtimi i asaj ankesë nëse konsideron se ka konflikt interesi apo ndonjë arsye tjetër për t’u larguar nga procedura dhe për këtë duhet ta njoftojë mbikëqyrësin kryesor shtetëror. Në këtë rast ankesa i caktohet ndonjë zyrtari/je tjetër. Ndonëse rregullorja në të cilën përshkruhet procedura e ankimit është e publikuar në ueb faqen e Agjencisë, ajo nuk është e paraqitur në ndonjë pjesë të dukshme dhe lehtë të qasshme për qytetarët.

Aktualisht agjencia ofron mundësinë a parashtrimin të ankesave online drejtpërdrejt nga ueb sajt i saj në dy forma: përmes formularit të thjeshtë “ Na shkruani” i cili gjendet në ballinën e ueb sajtit të Agjencisë, dhe përmes formularit “Ankohu Këtu”. Procesi i parashtrimin të ankesave online është i thjeshtë. Duhet të plotësohet një formular ku kërkohen të dhënat e personit parashtrues të kërkesës, përzgjedhja e organit ndaj të cilit parashtrohet ankesa, përshkrimi i ankesës dhe ngarkimi i dokumenteve që e dëshmojnë shkeljen, nëse ka. Gjithashtu, i njëjti formular mund të shkarkohet nga kjo ueb faqe dhe të dorëzohet në kopje fizike në zyrat e agjencisë. Përkundër faktit që numri i telefonit të Agjencisë është publikuar në ueb faqe, nuk ka indikacione të qarta që ky numër duhet të përdoret nga qytetarët për parashtrim të ankesave.

Për më tepër, aktualisht në ueb faqen e Agjencisë nuk ka të publikuara mjaftueshëm udhëzime, broshura, video informuese apo çfarëdo materiali tjetër që shpjegon qartë të drejtat e qytetarëve në aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe procesin e ankimit në rast të shkeljes së tyre.²⁵ Agjencia ka realizuar disa fushata vetëdijesuese lidhur me privatësinë mirëpo, nga aq sa është e dukshme në ueb faqen e Agjencisë, vetëm një spot përfshin të dhëna të kufizuara për procesin dhe mënyrat e ankimit.

Të drejtat e konsumatorëve

Informata për të drejtat e konsumatorëve	
Të plota	Pjesërisht
Relevante	Po
Të kuptueshme	Po
Të lehta për t’u gjetur	Po
Udhëzues të publikuar rreth mbrojtjes së konsumatorëve	Ka pak
Parashtrimi i ankesave	
Lehtësia e procesit	E lartë
Shpejtësia e procesit	E lartë
Mundësia për pyetje rreth procesit	Mesatare
Informata për rastet e ankesave të zgjidhura	Ka të publikuara

Tabela 4. Publikimi i të dhënave për të drejtat e konsumatorëve në ueb faqen e Agjencisë

Natyra e ankesave të qytetarëve të parashtruara te Agjencia

Ankesat e paraqitura në Agjenci kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj institucioneve qendrore, institucioneve lokale, sektorit bankar, kompanive të sigurimeve, sektorit shëndetësor, subjekteve politike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, qendrave tregtare, rrjeteve sociale etj. Në Agjenci thonë se kanë shqyrtuar çdo

²⁵ Gjatë tryezës tematike lidhur me llogaridhënien e rregullatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorit të mbajtur më 12 shtator 2018, Z. Valon Kryeziu, drejtori i departamentit ligjor në Agjenci, ka shpjeguar se Agjencia ka vendosur të mos iniciojë ndryshime në ueb faqen e saj në këtë periudhë, me arsyetimin se së shpejti pritet miratimi i projektligjit të ri për të dhënat personale dhe meqë kjo do të shkaktojë ndryshime në funksionimin e Agjencisë, do të shkaktojë edhe ndryshime në strukturën e ueb faqes së saj. Rrjedhimisht, çdo intervenim i tanishëm në ristrukturimin e ueb faqes do të përbënte një shpenzim të lartë të paarsyeshëm.

ankesë të pranuar gjatë këtyre viteve. Gjatë kohës sa pozita më e lartë në Agjenci ka qenë ajo e mbikëqyrësit kryesor shtetëror, i njëjti ka nënshkruar vendimet e marra ndaj ankesave të pranuar. Mirëpo, ky proces i shqyrtimit ka qenë i ndikuar negativisht nga mungesa e këshillit (Mbikëqyrësve shtetërorë) meqë, varësisht prej natyrës, për shqyrtim të disa ankesave kërkohet inspektim në zyret e kontrolluesit të të dhënave dhe kjo për dy vitet e fundit ka qenë e pamundur, duke lënë kështu shumë ankesa të pa trajtuara deri në fund.

Nga data 30 qershor 2016, kur mbikëqyrësit kryesor shtetëror i ka skaduar mandati, nënshkrimin e vendimeve e ka bërë drejtori i përgjithshëm i Agjencisë (si pozita më e lartë e mbetur brenda autoritetit, deri në përzgjedhjen e komisionerit si titullar i ri nga ana e Kuvendit të Republikës). Meqë, në saje të një ankese, si veprim i zakonshëm ka qenë inspektimi, të cilin sipas ligjit përkatës në fuqi kanë të drejtë ta bëjnë vetëm mbikëqyrësit shtetërorë, Agjencia, që nga 30 qershori 2016 nuk ka zhvilluar inspektime. Megjithatë, për të arritur qëllimin e jetësimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave, Agjencia ka ndërmarrë masa alternative si takimi me kontrolluesit e të dhënave ndaj të cilëve janë ankuar palët, kërkimi i dëshmimeve prej tyre lidhur me materien e ankesës, këshillimi i tyre se si të veprojnë në të ardhmen pa rënë ndesh me ligjin, dhe në të shumtën e rasteve është arritur qëllimi pa zhvilluar inspektime dhe pa bërë shkelje procedurale. I njëjti linjëveprim ad hoc do të vazhdojë të aplikohet deri sa të hyjë në fuqi projektligji i ri për MDhP, sipas të cilit, inspektimi do të jetë mandat i zyrtarëve të inspektimit (shërbyes civilë) dhe rrjedhimisht ankesat do të trajtohen në mënyrë më të lehtë, më të shpejtë dhe më efektive.

Viti	Nr. i ankesave	Natyra e ankesave
2012	16	Marketing i drejtpërdrejtë, zbulim dhe përpunim i paautorizuar i të dhënave, të dhëna të pasakta
2013	58	50 Facebook, marketing i drejtpërdrejtë politik, zbulim dhe përpunim i paautorizuar i të dhënave
2014	123	19 Facebook, 79 Marketing i drejtpërdrejtë politik, përpunim i paautorizuar i të dhënave, vëzhgimi me kamerë
2015	131	11 Facebook; 21 Marketing i drejtpërdrejtë politik, përpunim i paautorizuar i të dhënave, vëzhgimi me kamerë
2016	120	7 Facebook, 31 përpunim i të dhënave pa bazë ligjore, përpunim i paautorizuar i të dhënave
2017	78	Marketing i drejtpërdrejtë, zbulim i paautorizuar i të dhënave (të ndjeshme), përpunim i të dhënave jo të sakta

Tabela 5. Numri dhe natyra e ankesave të shqyrtuara nga Agjencia sipas viteve

Siç mund të shihet, numri i ankesave është rritur deri në vitin 2015 kur ka arritur në 131 dhe pastaj ka shënuar rënie në vitet 2016 dhe 2017. Me të dhënat në dispozicion është e vështirë të jepen interpretime për trendet ose shkaqet e paraqitjes së këtyre ankesave pranë Agjencisë. Një rritje e numrit të ankesave të paraqitura mund të shpjegohet njësoj me rritjen e numrit të rasteve të shkeljeve por edhe me ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e raportimit të shkeljeve dhe për Agjencinë si organ mbrojtës i privatësisë. Megjithatë, rritja e numrit të ankesave për marketing të drejtpërdrejtë politik në vitin 2014 mund të shihet si e lidhur drejtpërdrejtë me mbajtjen e zgjedhjeve në këtë vit dhe ky mund të jetë indikacion se edhe trendet e viteve të tjera mund të jenë të lidhura me ngjarje të ndryshme shoqërore të cilat kërkojnë studim të mëtejshëm.

3.4.4. Inspektimet

Kryerja e inspektimeve dhe kontrolleve është një prej kompetencave të Agjencisë në drejtim të realizimit të funksionit të saj për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për përpunimin e të dhënave personale. Inspektimi, me rregulloren Nr. 01/2012 për mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit, përcaktohet

si procedura me anë të së cilës bëhet zbulimi i drejtpërdrejtë rreth ligjshmërisë së punës dhe trajtimit nga ana e kontrolluesve dhe përpunuesve në mënyrë që të kontrollohet përputhshmëria e punës së tyre me ligjin dhe rregulloret tjera lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.²⁶ Përveç krijimit të një pasqyre të ligjshmërisë së punës dhe trajtimit nga kontrolluesit/përpunuesit e të dhënave, inspektimi ka për qëllim edhe parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve të ligjit në këtë fushë. Me ligj përcaktohet që inspektimet duhet të kryhen drejtpërdrejtë nga mbikëqyrësit (Mbikëqyrësi kryesor dhe katër mbikëqyrësit). Me projektligjin aktual parashihet që inspektimet të kryhen nga zyrtarët e inspektimit. Në rast të miratimit të këtij projektligji kjo mbetet të rregullohet më tej me akte të brendshme të Agjencisë.

Aspektet e mbrojtjes së të dhënave të cilat shikohen gjatë inspektimit janë: 1. ligjshmëria e përpunimit të të dhënave; 2. përshtatshmëria e procedurave dhe masave të ndërmarra për sigurinë e të dhënave; 3. zbatimi i dispozitave të Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që rregullojnë katalogun e sistemit të dosjeve, regjistrin e sistemit të dosjeve dhe regjistrimet e zbulimit të të dhënave personale tek marrësit; dhe zbatimi i dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare. Inspektimet e kryera nga Agjencia mund të jenë inspektime të rregullta, inspektime sipas ankesës dhe Inspektime sipas detyrës zyrtare. Inspektimet e rregullta kryhen në bazë të programit vjetor të miratuar nga Agjencia, i cili propozohet nga Mbikëqyrësit për secilin vit kalendarik. Ky program paraqet një listë me institucione publike për t'u kontrolluar. Në të përfshihen lloji i inspektimit, sistemet e dosjeve, numri i inspektimeve dhe kontrolleve të planifikuara që do të kryhen nga çdo mbikëqyrës dhe data e inicimit të inspektimit dhe kontrolluesit²⁷. Inspektimet sipas detyrës zyrtare bëhen në bazë të informacioneve për shkeljet e mundshme të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, të cilat merren në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nga mediumet²⁸. Në kuadër të këtyre inspektimeve hyjnë edhe inspektimet të tjera të cilat bëhen kur organe të ndryshme publike dhe private kërkojnë autorizime për përdorimin e të dhënave biometrike dhe për transferimin e të dhënave në vendet dhe organizatat ndërkombëtare të cilat nuk sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale të parapara me Ligj²⁹.

Që nga themelimi i saj Agjencia ka zhvilluar gjithsej 399 inspektime, shumica prej të cilave kanë qenë inspektime të rregullta. Numri i inspektimeve të realizuara ka shënuar rritje çdo vit. Kështu, nga 48 inspektime të realizuara më 2012 numri është rritur në 131 në vitin 2015. Në vitin 2016 ka pasur një numër relativisht të vogël të inspektimeve krahasuar me vitet paraprake. Kjo ka ndodhur për shkak se në mars të atij viti ka skaduar mandati i mbikëqyrësve dhe rrjedhimisht ka pushuar aktiviteti i inspektimeve. Njëherit kjo është pengesa më e madhe në punën e Agjencisë e shkaktuar nga mos-miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mos përzgjedhja e mbikëqyrësve të rinj shtetërorë. Numri i inspektimeve sipas llojit të inspektimit është paraqitur në tabelën më poshtë.

Viti	Nr. i inspektimeve	Lloji i inspektimeve		
		Të rregullta	Sipas ankesës	Sipas detyrës zyrtare
2012	48	37	4	7
2013	78	56	8	14
2014	114	76	28	28
2015	131	73	47	11
2016	28	1	22	5
2017	0	0	0	0

Tabela 6. Numri I inspektimeve të realizuara nga Agjencia sipas llojit dhe viteve

26 http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Finale-rregullore_per_inspektim_dhe_kontroll_me_nenin_20.3_te_ndryshuar.pdf

27 http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Finale-rregullore_per_inspektim_dhe_kontroll_me_nenin_20.3_te_ndryshuar.pdf

28 http://www.amdp-rks.org/repository/docs/ashmdhp_raporti_vjetor_2015_ALB.pdf 29

29 Raporti vjetor I punes ashmdhp 2016 faqe 26

Nga këto inspektime 27 raste janë proceduar më tutje në procedurë të rregullt gjyqësore siç parashihet në ligj. Në katërmbëdhjetë (14) raste është kërkuar ndalimi i përpunimit të të dhënave biometrike. Ndërsa, autorizimi për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale është dhënë në njëmbëdhjetë (11) raste, sipas ligjit dhe akteve nënligjore që e rregullojnë këtë fushë. Në tabelën në vijim jepet numri i inspektimeve për vit sipas llojit³⁰ të institucionit në të cilin është zhvilluar inspektimi. Nga këtu vërehet se numri më i madh i inspektimeve është zhvilluar në organet private dhe ky numër ka shënuar rritje përgjatë viteve, përderisa numri i inspektimeve në organet publike nuk ka pësuar rritje të madhe.

Viti	Nr. i inspektimeve	Natyra e inspektimeve		
		Organe publike qendrore	Organe publike lokale	Organe private
2012	48	19	6	23
2013	78	19	10	49
2014	114	26	26	64
2015	131	27	7	50
2016	28	4	2	22
2017	0	0	0	0

Tabela 7. Numri i inspektimeve të realizuara nga Agjencia sipas institucionit të inspektuar dhe viteve

3.4.5. Kontrollat

Për dallim nga inspektimet që zhvillohen me qëllim të vërtetimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, kontrollet zhvillohen me qëllim të verifikimit nëse procedurat e përpunimit të të dhënave personale janë në përputhje me rregullat (ligjet dhe aktet nënligjore) në fuqi. Siç përcaktohet me rregulloren Nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit, kontrolli paraqet “një kontroll sistematik dhe të pavarur për të përcaktuar se a kryhen aktivitetet që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale në pajtueshmëri me politikën dhe procedurat e mbrojtjes së të dhënave të kontrollorëve dhe përpunuesve, dhe se a përmbush ky përpunim kushtet e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”³¹. Kontrollet pasojnë inspektimet. Ato realizohen pas skadimit të afatit të paraparë për eliminimin e parregullsive sipas vendimit të marrë nga mbikëqyrësit me rastin e kryerjes së inspektimeve. Numri i kontrolleve të zhvilluara gjatë viteve 2012-2017 është dhënë në tabelën në vijim:




Figura 1. Numri i kontrolleve të realizuara nga Agjencia sipas viteve

Nga tabela shihet se numri i kontrolleve është relativisht i vogël krahasuar me numrin e inspektimeve, që lë të kuptohet se nga shumica e institucioneve brenda afateve janë ndërmarrë masat e caktuara nga mbikëqyrësit gjatë inspektimeve.

30 Numrat e dhënë paraqesin numrin e institucioneve të cilat janë inspektuar dhe jo numrin e inspektimeve që janë kryer, meqë në disa institucione janë kryer disa inspektime brenda vitit.

31 http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Finale-rregullore_per_inspektim_dhe_kontroll_me_nenin_20.3_te_ndryshuar.pdf

3.4.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar Agjencia ka përgjegjësi për vendosjen e marrëdhënieve bilaterale e multilaterale me shtetet tjera dhe me mekanizmat ndërkombëtare, krijimin e listës me shtetet që sigurojnë nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave, harmonizimin e legjislacionit vendor me atë evropian dhe dhënien e autorizimeve për organet/institucionet kosovare për transferimin e të dhënave jashtë vendit. Në këtë drejtim Agjencia ka arritur nivel të kënaqshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar që i mundëson ngritje të kapaciteteve njerëzore, shkëmbim përvojash, ekspozim ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të shkeljes së privatësisë dhe lehtësim të procesit të harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian.

Sa i përket procesit të harmonizimit të legjislacionit, zyrtarët e Agjencisë tregojnë se prej kohës që kanë filluar ndryshimet ligjore me qëllim të harmonizimit të ligjit me GDPR, ata kanë mbajtur konsultime, takime, trajnime, dhe prezantime me akterë të ndryshëm të Institucioneve, shoqatave, dhe OJQ-ve për t'i njoftuar ata me risitë që do t'i sjell Ligji i ri dhe obligimet e tyre në raport me GDPR-në dhe Ligjin e ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi veç e veç me Shqipërinë, Slloveninë, Hungarinë, Kroacinë dhe me Italinë dhe një memorandum shumëpalësh në mes të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë. Në përgjithësi këto memorandume parashohin shkëmbimin e përvojave dhe ekspertëve në mbrojtjen e të dhënave dhe bashkëpunimin në fushën e ndërtimit të kapaciteteve, përfshirë organizimin e trajnimeve e punëtorive për këtë qëllim dhe organizimin e eventeve të tjera të përbashkëta.

Po ashtu, Agjencia është anëtarësuar si anëtare me të drejta të plota dhe si vëzhgues në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale. Këto mekanizma përfshijnë Grupin e Berlinit³², Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë; Rrjetin Global për Forcimin e Privatësisë "GPEN", Konferencën Pranverore të Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave etj. dhe rrjedhimisht ka qenë pjesëmarrëse në konferencat dhe punëtoritë³³ e organizuara nga këta mekanizma. Gjithashtu, përfaqësues të Agjencisë kanë bërë vizita studimore në autoritet për mbrojtjen e të dhënave të vendeve të ndryshme si Gjermania, Bullgaria dhe Polonia, të cilat kanë pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Anëtarësimi i Agjencisë në mekanizmat ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në organizime ndërkombëtare për mbrojtjen e privatësisë mund të shërbejë si një mundësi e mirë për t'u njohur me praktikat ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të shkeljes së privatësisë, por gjithashtu edhe për të promovuar punën e institucioneve kosovare në këtë fushë. Matja e rezultateve të prekshme të këtyre bashkëpunimeve është e vështirë dhe para së gjithash do të kërkonte një vlerësim të kualitetit të marrëveshjeve të nënshkruara, natyrën e eventeve në të cilat Agjencia ka marrë pjesë, nivelin e mbrojtjes së të dhënave të shteteve përkatëse me të cilat Agjencia ka lidhur marrëveshje, cilësinë e aftësive të fituara nga zyrtarët e Agjencisë si pasojë e këtyre bashkëpunimeve dhe zbatimin e tyre në operacionet e përditshme të Agjencisë. Sipas zyrtarëve të Agjencisë, për shkak të rëndësisë që ka mbrojtja e të dhënave dhe për shkak se kjo çështje tani është shndërruar në prioritet dhe problem global, ata kanë pasur përkrahje të institucioneve të tjera shtetërore për shtrirje të bashkëpunimit ndërkombëtar. Ata gjithashtu thonë se në tri vitet e fundit nuk ka pasur probleme financiare sa i përket përfaqësimit ndërkombëtar të Agjencisë dhe problemet e vetme me të cilat janë ndeshur zyrtarët e Agjencisë kanë qenë të lidhura me procesin e marrjes së vizave.

³² Grupi Punues Ndërkombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikime është themeluar në 1983 në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave. Autoriteti për Mbrojtjen e të Dhënave i Berlinit është në krye të sekretariatit të këtij grupi punues, i cili njihet edhe si Grupi i Berlinit.

³³ Konferencën Ndërkombëtare me temën "Modernizimi Legjislacionit Evropian në fushën e të Dhënave Personale", e cila është mbajtur në Shkup prej 30 deri me 31 Maj 2012; 2. Konferencën Ndërkombëtare të Privatësisë, e cila u mbajt në Mauricius; 3. Punëtori rreth mbrojtjes së të dhënave personale

Siç u përmend më sipër, Agjencisë me ligj i përshkruhet edhe përgjegjësia për rregullimin dhe mbikëqyrjen e transferimit të të dhënave jashtë vendit. Me nenin 41 të ligjit përcaktohet që transferimi i të dhënave personale që janë përpunuar ose që do të përpunohen në vende të tjera dhe tek organizatat e tjera ndërkombëtare mund të bëhet vetëm nëse këto shtete sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Agjencia mban një listë për këtë qëllim, në të cilën përfshihen të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane, shtetet për të cilat agjencia merr vendim se kanë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave dhe shtetet për të cilat organi kompetent i Bashkimit Evropian ka konstatuar se kanë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Ndërlidhja e punës së ASHMDP-së me punën e institucioneve të tjera

ASHMDP me ligj është përcaktuar si agjenci e pavarur, duke iu referuar faktit që vendimet e saj duhet të jenë të pandikuara apo të pa udhëzuara nga palë të jashtme. Megjithatë, realizimi i plotë i funksioneve të saj është i lidhur ngushtë me punën e institucioneve të tjera shtetërore. Ministria e Administratës Publike përcakton numrin e punëtorëve të Agjencisë, Ministria e Financave përcakton buxhetin që do t'i alokohet Agjencisë, Kuvendi i Kosovës e mbikëqyrë punën e saj, gjykatat trajtojnë rastet/paditë e ngritura nga Agjencia në rast të shkeljes së të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucione apo organizata të ndryshme, Policia e Kosovës ofron mbështetje për mbikëqyrësit me rastin e hasjes në rezistencë gjatë inspektimeve, etj. Një lidhshmëri kaq e madhe padyshim që krijon edhe hapësirë për ndikim pozitiv dhe negativ të këtyre institucioneve në punën e Agjencisë.

4.1. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës dhe ndikimi i tij në punën e ASHMDhP-së

Kuvendi i Kosovës është organi që e mbikëqyrë punën e Agjencisë. Ai emëron dhe shkarkon Këshillin e saj (Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror dhe Mbikëqyrësit Shtetëror), miraton buxhetin e Agjencisë dhe shqyrton raportet e saja vjetore të punës. Në anën tjetër, Kuvendi është i obliguar ta informojë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale dhe të konsultohet me të para miratimit të masave të tilla.

Publikimi dhe dorëzimi i raporteve vjetore

Me nenin 44 të ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia obligohet ta publikojë dhe ta dorëzojë në Kuvendin e Kosovës raportin vjetor të punës më së largu deri më 31 Mars të vitit vijues. Raporti shqyrtohet fillimisht nga Komisioni funksional mbikëqyrës dhe pastaj edhe nga komisioni për buxhet dhe financa (vetëm sa i përket raportit financiar) dhe kalon në Kuvend për aprovim, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Deri më tani Agjencia ka publikuar raportet e punës për vitet 2012 deri më 2015 në ueb faqen e saj. Kur janë pyetur për arsyen e mos-publikimit të raporteve të viteve 2016 dhe 2017, drejtuesit e Agjencisë kanë shpjeguar se ata si institucion e ndjekin praktikën e publikimit të raporteve vetëm pas miratimit të tyre nga Kuvendi dhe deri në kohën kur kemi zhvilluar intervistën me drejtuesit e Agjencisë këto raporte nuk kanë janë

të qytetarëve të huaj, duke përfshirë azilkërkuesit (Shqipëria, Kosova, Turqia, Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Serbia) në Maqedoni më 2015; 4. Punëtorinë e 27-të Ndërkombëtare të Trajtimit të Rasteve Specifike (Agjencia ka bërë prezantim mbi trajtimin e rasteve të përpunimit të të dhënave biometrike në Kosovë); 5. Konferencën e 18-të të Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore në Sarajevë.

miratuar nga Kuvendi. Mirëpo ata thonë se i është mundësuar qasja në këto raporte çdo kujt që ka kërkuar atë. Raporti i vitit 2016 nuk është shqyrtuar me arsyetimin e mungesës së Këshillit të Agjencisë i cili në atë kohë nuk ka pasur mandat nga data 23.03.2016, kurse Raporti i vitit 2017 është aprovuar nga Kuvendi më 23 korrik 2018.

Raportet vjetore të Agjencisë karakterizohen me përsëritje të përmbajtjes përgjatë të gjithë këtyre viteve të raportimit. Disa nga seksionet që përsëriten çdo vit dhe shtojnë volumin e raporteve janë: korniza ligjore, përgjegjësitë dhe autorizimet, vizioni dhe misioni, korniza ligjore, organizimi dhe fushëveprimi, etj. Njëherit, ky fenomen është vërejtur edhe në raportet e agjencive të tjera ³⁴ të pavarura dhe është ngritur si çështje që duhet të adresohet me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes së agjencive nga komisionet funksionale parlamentare.

Raportimi i Agjencisë në Komisionin Parlamentar

Janë kërkuar intervista me të gjithë deputetët anëtarë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës në legjislaturën e pestë dhe të gjashtë lidhur me raportimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në këtë komision, mirëpo vetëm katër (4) nga këta tetëmbëdhjetë (18) deputetë i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për takim dhe për zhvillim të intervistës. Të gjithë deputetët e intervistuar pohojnë se kanë njohuri mbi sferat që rregullon ASHMDHP-ja. Njësoj, sa i përket mbikëqyrjes së ASHMDHP-së, të gjithë thonë se komisioni ka përgjegjësi vetëm për thirrje të Agjencisë në raportim dhe për shqyrtim të raportit vjetor të punës së saj.

Komisioni/Anëtarët e tij nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në planifikimin strategjik të ASHMDHP-së dhe ata janë të vetëdijshëm për këtë. Të katër (4) deputetët e intervistuar thonë se ata si komision kanë dhënë vetëm vlerësime dhe rekomandime bazuar në raportimin vjetor të Agjencisë. Ndonëse të gjithë deputetët kanë deklaruar se janë të informuar për situatën dhe zhvillimet e fundit në Agjenci, vetëm një nga ta ka qenë në gjendje të flasë për mos-përzgjedhjen e Këshillit të Agjencisë dhe pasojat e këtij fakti në punën e Agjencisë.

Tutje, deputetët janë pyetur se sa shpesh raporton Agjencia në Komisionin për Punë të Brendshme dhe vetëm njëri nga ta nuk ka mundur të japë përgjigje specifike. Të gjithë deputetët e intervistuar vlerësojnë se deri më tani raportimi nga Agjencia ka qenë shumë i qartë dhe objektiv. Disa madje kanë vlerësuar se raportet e ASHMDHP-së janë raportet më cilësore dhe të detajuara nga të gjitha raportet që dorëzohen për shqyrtim në këtë komision dhe se ato kanë informacione të mjaftueshme për shqyrtimin e punës së Agjencisë. Megjithëse deputetët/anëtarët e komisionit kanë të drejtë të kërkojnë editim të raportit nga Agjencia, ata thonë se asnjëherë se kanë bërë këtë meqë raportet kanë qenë të plota dhe cilësore.

Më pas, anëtarët dhe ish-anëtarët e komisionit janë pyetur rreth njohurive të tyre për të drejtat e privatësisë, organet ku duhen raportuar shkeljet e privatësisë, sanksionet që mund të ndërmerren dhe nëse ata personalisht kanë raportuar ndonjë rast të shkeljes së të drejtave të tyre të privatësisë. Të gjithë pohojnë se kanë njohuri për të drejtat e konsumatorëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë. Gjithashtu ata shprehën se e dinë kush i trajton ankesat e konsumatorëve dhe ku duhet të ankohen për raste të tilla. Megjithatë ata nuk kanë njohuri të zgjeruara për sanksionet që aplikohen në rast të shkeljes së të drejtave të privatësisë. Tre nga deputetët kanë thënë se nuk janë ankuar asnjëherë për shkeljen e të drejtave të tyre të privatësisë, përderisa deputeti Rexhep Selimi ka deklaruar se e ka ngritur para Agjencisë çështjen e shkeljes së të drejtave të tij të privatësisë në disa raste, mirëpo jo me qëllimin për t'u ankuar por për të përdorur shembullin personal si rast ku shkelen të drejtat e privatësisë.

5. Shpenzimet, Transparenca dhe Llogaridhënia e Agjencisë

Në agjenci e shohin buxhetin e pamjaftueshëm si një ndër shkaktarët kryesorë të problemeve në funksionimin e saj pasi që pamjaftueshmëria e buxhetit ka rezultuar në numër shumë më të vogël të punonjësve sesa është paraparë me strukturën organizative të Agjencisë. Tabela në vijim paraqet buxhetin e realizuar të Agjencisë për vitet 2012-2017.

Përshkrimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	212,288	268,062	348,713	369,682	371,101	281,001
Granti i Qeverisë-Buxheti	212,288	268,062	337,167	369,682	361,811	281,001
Donacionet e jashtme	-	-	11,546	-	9,290	-
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	212,288	268,062	348,712	369,682	371,101	281,001
Pagat dhe Mëditjet	117,811	162,358	208,358	183,567	159,772	141,724
Mallrat dhe Shërbimet	94,056	103,343	139,134	132,739	156,401	105,619
Shërbimet Komunale	421	2,361	1,220	3,486	11,569	7,960
Shpenzime Kapitale	-	-	-	49,890	43,359	25,698

Tabela 8. Të dhënat financiare të Agjencisë sipas viteve

Për qëllime të këtij hulumtimi, niveli i transparencës së Agjencisë është matur duke vlerësuar nivelin e publikimeve në Ueb faqen e Agjencisë për aspekte të ndryshme si: përgjegjësia, veprimtaria, strategjia, kontakti, buxheti dhe të dhënat financiare, organogrami dhe të dhënat për stafin, të dhëna për të drejtat e konsumatorëve, për rastet e ankesave të zgjidhura etj. të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Institucioni : ASHMDP	
Data: 22 Maj 2018	
Ueb adresa: www.amdp-rks.org	
Informacionet ne Ueb faqe	
Puna e institucioni	
Përgjegjësiti	Po
Veprimtaria	Po
Strategjia	Po
Kontakti	Pjesërisht

Buxheti dhe të dhënat financiare të prezantuara në raportimet vjetore

Të plota	Po
Të kuptueshme	Po
Të organizuara	Po
Relevante	Po
Të përpunueshme	Jo

Të dhënat për anëtarët

Organogrami	Po
Lista e anëtarëve të organeve udhëheqëse	Pjesërisht
Biografite e anëtarëve të organeve udhëheqëse	Pjesërisht
Kontakti i anëtarëve të organeve udhëheqëse	Po

Ligjet



1

Rregulloret




9

Udhëzimet



1

Vendimet



56

Publikimi i Legjislacionit



2018



2017



2016

Numri i anëtarëve që kanë deklaruar pasurinë

Prezantim i aktiviteteve	
Strukturimi i të dhënave	Mesatar
Azhuriteti me lajme	Kënaqshëm
Web responsive	Jo

6. Përfundime dhe rekomandime

Nga sa u tha më lartë mund të përfundohet se:

1. Qytetarët e Kosovës mund të mbështeten në institucionet e vendit sa i përket shkeljeve të rënda të privatësisë dhe abuzimit me të dhënat e tyre personale. Sidoqoftë, e njëjta nuk vlen sa i përket keqpërdorimit të të dhënave për qëllime komerciale në shkallë të vogël.
2. Pa marrë parasysh ekzekutimin e disa fushatave promovuese, nuk ka shënime faktike se sa ato kanë pasur efekt pozitiv në vetëdijesimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë, punën e Agjencisë apo raportimin e rasteve të shkeljes së privatësisë.
3. Përdorimi i ankesave si matës i shkeljeve të privatësisë nuk paraqet indikator as të trendëve e as të nivelit të punës së institucioneve, mungon përcjellja e vazhdueshme e natyrës së ankesave dhe një analizë e mirëfillte e tyre në kuptim të përgjithshëm.
4. Nuk ka ndonjë tendencë të trajtimit të shkeljeve të ndryshme në mënyrë të veçantë në kuptim të prioritizimit, Agjencia nuk ka metoda se si të përcjellë trendët apo të përpunojë shënime statistikore me qëllim të ndarjes së shkeljeve nëpër kategori.
5. Agjencia nuk është duke shfrytëzuar mjaft mundësinë e informimit dhe bashkëpunimit me qytetar përmes ueb faqes dhe rrjeteve sociale.
6. Kuvendi duhet të mbikëqyrë shumë më mirë punën edhe të kësaj Agjencie, anëtarët e komisionit përkatës duhet të jenë më mirë të përgatitur, por edhe stafi administrativ i Kuvendit duhet të gjejë mënyra që tranzicionet ndërmjet deputetëve të trajtohet dhe të mos ketë ndikime negative në mbikëqyrjen e agjencive të pavarura.

Bazuar në këto përfundime mund të rekomandohet që:

- i. Grumbullimi i të dhënave personale të qytetarëve të Kosovës nga operatorët ekonomik përmes aktiviteteve të marketingut siç janë lojërat shpërblyese, anëtarësimet, kartat e lojalitetit etj. do të duhej të ketë trajtim të veçantë
- ii. Fushatat informuese, kampanjat për ngritje të vetëdijes dhe aktivitetet tjera me synime të ngjashme do të duhej të përfshijnë më shumë qytetar dhe do të duhej të jenë a) të bazuara në rreziqet dhe b) me rezultate të matshme.

- iii. Ankesat e qytetarëve duhen të trajtohen edhe si informatë statistikore dhe indikator i trendëve e jo vetëm si raste individuale. Po ashtu, duhet të bëhet më shumë që qytetarët të informohen për rastin e tyre duke filluar nga momenti kur ankohen por edhe përgjatë tërë procesit të shqyrtimit.
- iv. Agjencia duhet medoemos të studiojë trendët dhe të prioritzojë trajtimin e sektorëve në baza të nevojës reale dhe rrezikut të matur e jo të para-supozuar.
- v. Ueb faqja e Agjencisë duhet të përmbajë më shumë informata dhe ato të jenë të prezantuara në mënyre shumë më të shfrytëzueshme. Po ashtu, aktiviteti në rrjete sociale duhet të rritet.

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



www.ngolens.org

